

BEDRI ÇOKU



Zëdhënës Shtypi në KLSH dhe Përgjegjës për Marrëdhëniet me Publikun.

Lindur në 1949.

13 vite eksperiencë pune dhe 23 vite i burgosur i ndërgjegjes. Autor i disa librave në letersi e publicistikë.

2 vitet e fundit në KLSH Zëdhënës Shtypi në KLSH dhe Përgjegjës për Marrëdhëniet me Publikun.

Fusha e ekspertizës: Jurisprudenca dhe marrëdhëniet me publikun.

KOLANA E BOTIMEVE NË KONTROLLIN E LARTË TË SHETITⁱⁱⁱ nga Bedri Çoku

Në realizim të misionit të tij kushtetues për të informuar publikun dhe në bazë të Deklaratës së Limës (ISSAI 1) të vitit 1977, e konsideruar Kushtetuta e Institucioneve të Auditimit më të Lartë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqitet publikut shqiptar kolanën e tij të botimeve KLSH. Qellimi i këtyre botimeve është implementimi i strategjisë EUROSAT 2011-2017 dhe strategjisë së KLSH 2012-2017, mundësimi i publikut të gjerë dhe përdoruesve specifikë të përfitojnë një perspektivë dhe kuptim më të mirë të praktikave dhe profesionalizmit të institucionit. Po Ashtu KLSH synon stimulimin e memories institucionale, të kompetencës profesionale të audituesve, si dhe ofrimi i bazave për kryerjen me sukses të auditimeve të tilla, si ai i performancës. Botimet përfaqësojnë punën e përbashkët sipas motos së INTOSAI-t, komunitetit të institucioneve supreme të auditimit publik “*Experientia mutua Omnibus Prodest*” (Nga eksperiencia e përbashkët

përfitojmë të gjithë), për të kontrolluar me përgjegjësi e imtësi fondet e buxhetit të shtetit, për të rritur zbatueshmërinë e rekomandimeve të institucionit në përmirësimin e performancës së qindra institucioneve të audituara dhe për të luftuar me efikasitet korrupsionin e ndihmuar mirëqeverisjen.

Botimet e KLSH pasqyrojnë dhe reflektojnë katër objektivat themelore të Strategjisë së Zhvillimit të EUROSAI 2011-2017, dhe pikërisht ndërtimin e kapaciteteve, standardet profesionale, shkëmbimi e njohurive dhe eksperiencave dhe menaxhimin në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe komunikimit efektiv. Kjo kolanë, e cila do të pasurohet nga viti në vit, pasqyron reformat e thella që ka nisur institucioni, për të konsoliduar auditimin financiar dhe kthyer vëmendjen tek auditimi i performancës, jep kontributin në mirëqeverisjen publike, duke parandaluar dhe luftuar në sistem korrupsionin, si dhe përpjekjet e KLSH për të rritur kapacitetet e tij audituese, në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve ndërkombëtare të fushës, INTOSAI.

Më konkretisht:





Botimi “EUROSAI” (Institucionet Supreme Evropiane të Auditimit) pershkruan organizatën EUROSAI (Organizata Evropiane e Institucioneve më të Larta të Auditimit), komunitetin e institucioneve supreme të auditimit (SAI) të kontinentit, duke dhënë profile për secilin SAI evropian. EUROSAI është organizata që përmbledh 50 anëtarë, nëpërmjet së cilës SAI-t zhvillojnë kongrese, konferenca dhe aktivitete të tjera trajnimi e shkëmbimi reciprok eksperiencash, nën moton e INTOSAI-t “*Experientia mutua omnibus prodest*”(nga eksperiencia e përbashkët përfitojnë të gjithë). Botimi jep po ashtu informacion për mënyrën e organizimit dhe funksionet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, organit më të lartë auditues të Bashkimit Evropian.

Botimi “Historiku i Kontrollit të Lartë të Shtetit” ka rëndësi, pasi kujtesa historike është një nga përbërësit më të fuqishëm në krijimin e identitetit të qëndrueshëm, jo vetëm të një kombi, por edhe të një institucioni kryesor shtetëror. Historiku i KLSH mundëson të shikohen fillesat e këtij institucioni suprem të auditimit, shumë të rëndësishëm për mbrojtjen e interesave të qytetarëve dhe të Kuvendit në administrimin e parasë publike dhe evidentohen format që ai ka marrë në rrjedha të ndryshme të historisë së shtetit shqiptar, duke vlerësuar të gjithë ata që ndihmuan në formësimin e institucionit si një institucion bazë i shtetit shqiptar. Përshkruan periudhat 1925-1944; 1944-1991 dhe 1992-2012.

Revista “Auditimi Publik” është revistë katërmujore kërkimore, shkencore dhe informative dhe synon të jetë një forum i ideve, gjetjeve, opinionëve, vrojtimeve dhe studimeve në fushën e auditimit publik, të sjella nga personalitete të kontabilitetit, financave publike, auditimit dhe jurisprudencës të vendit dhe të huaja. Revista botohet në shqip dhe anglisht.

Botimi “Standartet e Auditimit INTOSAI” (ISSAI) sjell në vëmendje të publikut, në rradhë të parë të audituesve të sektorit publik standartet ndërkombëtare të profesionit të audituesit publik suprem, të quajtura Standartet e Auditimit të INTOSAI. Këto standarde të Auditimit përmbajnë postulatet themelore dhe parimet për kryerjen e punës së auditimit nga institucionet supreme të auditimit (SAI). Botimi prezanton tre nivelet e para të standardeve dhe pikërisht standartet ISSAI 1 (Deklarata e Limës), ISSAI 10 (Deklarata e Meksikos), 11, 20, 21, 30 dhe 40, si dhe Rezolutën e OKB-së të 22 dhjetorit 2011 për mbështetjen që parlamentet dhe qeveritë e shteteve anëtare duhet t’u japin SAI-ve.

Botimi “Udhëzuesi i Auditimit të Performancës” është rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të anëtarëve të Komitetit të Standarteve të Auditimit INTOSAI dhe përbën një hap të rëndësishëm përpara në procesin e përforcimit të auditimit të performancës midis auditimeve publike. Ai nuk është një dokument normativ apo teknik, apo një referencë e shpejtë, por përmban një numër udhëzimesh dhe informacionesh të tjera me implikime praktike, që marrin në konsideratë kushtet specifike dhe karakteristikat e auditimit të performancës. Udhëzimet përfaqësojnë praktikën më të mirë aktuale të auditimit të performancës dhe përcaktojnë krejt strukturën që udhëheq konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e auditimit të performancës.

Kolana e botimeve të KLSH përmban disa publikime informative për analizat periodike si dhe raportet e institucionit me Kuvendin. Komunikimi nëpërmjet librit si pjesë e komunikimit me publikun e gjerë është një nga elementët më të rëndësishëm për realizimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik. Këtë eksperiencë pozitive të vitit 2012 dhe deri tani, KLSH do ta vazhdojë edhe në vitet në vijim, në mënyrë që botimet dhe transparenca e aktivitetit të tij edhe nëpërmjet librit të kthehen në kulturë pune për Institucionin.

ⁱ Botuar në Gazetën “Republika” dt. 07 Maj, 2013

ⁱⁱ Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Për KLSH, paraja e shtetit është paraja e qytetarit (Republika, 12 prill 2013)
- Për KLSH, paraja e shtetit është paraja e qytetarit (Metropol, 12 prill 2013)
- KLSH dhe misioni i tij informues (Ekonomia, 09 maj 2013)
- Bisturia e KLSH (Metropol, 18 maj 2013)
- Roli i qytetarëve në përmirësimin e qeverisjes (Metropol, 09 qershor 2013)
- Rritja profesionale e Kontrollit të Lartë të Shtetit (Republika 07 shtator 2013)

-
- Rritja profesionale e Kontrollit të Lartë të Shtetit , është zhvillim i ekonomisë së vendit (Metropol 07 shtator 2013)
 - Nga vjen fuqia goditëse e KLSH (Republika 15 tetor 2013)
 - KLSH dhe Bashkimi Evropian (Ekonomia, 26 tetor 2013)
 - KLSH dhe rekomandime për qeverisje më të mirë (Ekonomia 06 nentor 2013)
 - KLSH dhe rekomandime për qeverisje më të mirë (Republika 06 nentor 2013)
 - Kontrolli i Lartë i Shtetit shton mbështetjen ndaj buxhetit...(Ekonomia 4 dhjetor 2013)